



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr.17/2018

Prishtinë, më 27.2.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari - Lila, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi, Gani Dreshaj dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj dhe Qëndron Kastrati, anëtarë.

I ftuar: Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Besnik Beka, zëvendësministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Rexhep Bllaca, Faton Perezi, Nysret Vojvoda, Alush Kryeziu, Mervan Rexhepi, MTI; Ibrahim Rexhepi, MZHE; Dren Ajeti, KPK; Arbër Kadriu, BIRN; Detjan Hulaj, ICHAT; Qëndresa Kastrati, INDEP dhe Albert Krasniqi, KDI.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha -Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.2.2018;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Mimoza Kusari – Lila, tha se dje është mbajtur takimi i grupit të punës dhe është përcjellë edhe materiali. Mendoj se ka qenë një takim mjaft i frytshëm dhe do të ishte mirë që ta shtonim si pikë të rendit të ditës edhe raportin e grupit të punës për Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik.

Rendi i ditës u plotësua me propozimin e deputetes Mimoza Kusari – Lila.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.2.2018

Dardan Sejdiu, kërkoi sqarim lidhur me procesverbalin e datës 7.2.2018, te pjesa e "Pallatit të Rinisë", përfundimi është shkruar saktë, deri te presja e fundit, por pas saj, shkruhet pa rekomandim të komisionit. U konsultova edhe me kolegë deputetë dhe që të gjithë kemi një përshtypje që kemi ecur tutje me rekomandim të komisionit. Lidhur me këtë kërkoi korrigjim edhe një herë të këtij procesverbali.

Kryetarja, kërkoi nga stafi i komisionit, që të marrë parasysh këtë kërkesë dhe ta verifikojnë këtë në bazë të incizimit të mbledhjes.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 7.2.2018, rishikohet me propozim të zëvendëskryetarit të parë, Dardan Sejdiu, ndërsa miratohet pa vërejtje procesverbali i mbledhjes së datës 21.2.2018.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe

Kryetarja, tha se e kemi shtyrë një herë këtë projektligj, me kërkesë të komisionit, që të vijë në pako me dy projektligje tjera, por pastaj kemi pranuar një letër nga ministri dhe në mbledhjen e kaluar u pajtuam që të përfshihet në rend dite edhe një herë.

Dardan Sejdiu, tha se kemi pasur një dakordim në lidhje me trajtimin e projektligjeve që kanë të bëjnë me krijimin e hapësirës së kornizës ligjore për ndihmë ndaj prodhimit vendor. Po ashtu, kemi folur për një pako prej tre ligjeve, dhe neve, prapë na është sjellë projektligji i vetëm. Meqenëse është zëvendësministri këtu, duhet ta kenë parasysh që nuk mund të flasim për një projektligj ndaras prej projektligjeve të cilat kanë të bëjnë me prodhimin vendor, sepse po krijojmë probleme në zbatimin e këtyre ligjeve. Ne, si komision, kemi qenë të qartë në këtë pikë, i kemi dërguar edhe shkresë ministrisë përkatëse. Mendoj që është një qëndrim i këtij komisioni që këto projektligje, derisa të mos vijnë në pako, të mos i trajtojmë.

Bilall Sherifi, tha se nëse nuk gabo, nuk ka qenë ideja që ne të marrim një vendim që këto tri projektligje të mos i trajtojmë veç e veç, por ka qenë një këshillë që ia kemi rekomanduar ministrisë përkatëse dhe kemi qenë në gatishmëri që si komision të bashkëpunojmë dhe t'u ndihmojmë, që së bashku t'i trajtojmë. Por, nëse ministria i ka arsyet e veta se, pse nuk duhet të

procedohet në këtë mënyrë, atëherë mendoj që, si komision, në këtë fazë ta procedojmë, e mandej seanca e Kuvendit vendos sesi të vazhdojmë tutje.

Dardan Sejdiu, proceduralisht, ne nuk kemi mekanizëm ta ndalim agjendën legjislative, por besoj që, si komision, kemi kapacitete të mjaftueshme dhe është e rrugës që korniza ligjore që merret me prodhuesin vendor, të trajtohet si e përbashkët, dhe në këtë formë, ne edhe si komision, mund të japim ndihmën adekuatë. Do të doja që Qeveria ta marrë këtë si sugjerim, këshillë, dëshirë për punë të anëtarëve të këtij komisioni, si një hap pozitiv për të punuar së bashku. Nëse Qeveria vendos që të ecë tutje fragmentalisht me këtë temë, atëherë ne si grupe parlamentare dhe si deputetë do të ngremë këtë çështje edhe në seance plenare.

Bilall Sherifi, tha se kontributi i deputetëve të opozitës në këtë komision është i pamohueshëm, mirëpo, nëse ministria nuk është e gatshme që në këtë fazë të pranojnë rekomandimin që kemi dhënë ne, si komision, atëherë më mirë te ecim në këtë mënyrë, sesa të ndalemi në tërësi.

Faton Thaçi, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë, tha se për shkak të angazhimeve të ministrit, sot do të jem përfaqësues i ministrisë, ku edhe një herë dua të mbroj qëndrimin e ministrisë, për t'i proceduar këto projektligje ndaras dhe nuk dua të shtoj asgjë më shumë se sa në përgjigjen me shkrim që i kemi dërguar këtij komisioni, për arsyen e procedimit veç e veç të këtyre projektligjeve. Duke parë këto rrethana, ne kemi ndarë këto projektligje dhe i kemi proceduar ndaras, njëkohësisht rregullat e BE-së bëjnë një ndarje, ku veç është fusha e trajtimit të importeve dhe veç është fusha e trajtimit të antidampingut dhe ligjeve të tregtisë. Dua të them se projektligjet derisa të vijnë këtu janë tonat, por, nga kjo fazë e tutje janë të përbashkëta, andaj kërkoj nga ju mirëkuptimin dhe të procedojmë tutje.

Dardan Sejdiu, tha se në botën ekonomisë së tregut, janë 11 shkolla të mendimit ekonomik. Një nga këto shkolla, që unë mundohem ta përfaqësoj, është edhe shkolla e shtetit zhvillimor. Ne jemi duke folur për zbatimin e rregullave të lojës në një vend i cili ka disbalancë tregtar, mungesë të zhvillimit industrial, rregulla të lojës që përshtaten për dikë që ka zhvillim tepër të madh industrial dhe nevojën për tregje të reja. Besoj se e kuptoni rëndësinë që t'i trajtojmë në pako këto projektligje, sepse jemi të interesuar që këtë potencial, sado që është i vogël, ta trajtojmë në mënyrë koherente.

Mimoza Kusari – Lila, tha se prej takimeve tona të para, në këtë komision, jemi pajtuar që duhet të bëhet trajtimi në pako i këtyre projektligjeve, me qëllimin e vetëm që t'i ndihmojmë ekonomisë prodhuese të shtetit tonë, që të ketë një siguri apo garanci për prodhuesin vendor. Tani, dua ta di zyrtarisht nga departamenti ligjor i ministrisë, se pse nuk po ndodh ajo për të cilën jemi dakorduar, që ta kemi një pako ligjore edhe në agjendën legjislative. Këtu nuk është synimi as për të bllokuar, as ta kthejmë mbrapa, por ideja është që të kemi mundësi të mirëfilltë të trajtimit të ligjeve si të përbashkëta, që nëse ka gjëra kundërthënëse, ne këto ligje t'i trajtojmë bashkërisht.

Hykmete Bajrami, tha se duke iu referuar deklaratës së zëvendësministrit, unë dua të bëj me dije zëvendësministrit se gjatë dy viteve e 7 muaj, sa herë kemi kërkuar të marrim masa për rastet e antidampingut, ligji nuk na ka lejuar, për shkak që ky ligj është tepër i komplikuar në procedura dhe për këtë arsye është kërkuar të ndryshohet, në mënyrë që të bëhet më i

implementueshëm. Ne jemi këtu për të mirën e prodhuesve vendorë, e jo për të bërë politikë dhe asnjëri nga ne nuk besoj të ketë interes personal.

Kryetarja, tha se komisioni nuk mund ta mbajë në pafundësi këtë projektligj, pa e dërguar në seancë dhe seanca është ajo që vendos për ta kthyer ose për ta proceduar tutje. Është hera e tretë që diskutohet në komision që këto ligje të vijnë në pako, por krejt në fund, ne kemi të drejtë që të fillojmë me procedurara për nisma ligjore, ku procedurat janë edhe më të shkurtra se sa të vijë nga Qeveria. Mirëpo, në këtë rast, mendimi im është që, me këtë projektligj, ne duhet t'i japim mundësinë, për ta përcjellë në seancë dhe pastaj seanca le të vendosë.

Rexhep Billaca, drejtor i Drejtorisë Ligjore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, tha se Rregullorja e punës së Qeverisë, para çdo iniciative legjislative, ka prezantuar koncept-dokumentin dhe zonja Hykmete Bajrami, kur ka qenë ministre në vitin 2016, ne kemi përfshirë koncept-dokumentin për masa mbrojtëse në importe dhe që atëherë ka qenë ideja për ligjin për masat mbrojtëse. Rekomandimi i koncept-dokumentit ka qenë që për realizimin e kësaj politike të miratohet ligji për masat mbrojtëse, ndërsa sa i përket ligjit për masat antidamping, ne kemi bërë një analizë dhe rekomandimi ka qenë se nuk ka nevojë të amendamentohet, sepse është në përputhje me parimet ligjore të OBT-së, në përputhje me Rregulloren 2015-478 të BE-së për masat antidamping, por edhe prej Komisionit Ndërministror për masat mbrojtëse antidamping, nuk kanë rekomanduar të bëjmë plotësim-ndryshim. Kështu që, qëndrimi ynë, si ministri, është që ligji për masat antidamping nuk ka nevojë që të amendamentohet, sepse nuk ka ndonjë arsye, por nëse komisioni ka ndonjë rekomandim konkret, ne mund ta shqyrtojmë. Mirëpo, vetëm si rekomandim i përgjithshëm është problem që të arsyetohet, që të përfshihet në agjendën legjislative të Qeverisë. Ju njoftoj se edhe më herët, këto ligje kanë shkuar veç e veç dhe nuk e kanë penguar njëri-tjetrin. Sa i përket hartimit të ligjit për tregti të brendshme, mendimi im dhe i ekspertëve të BE-së, është që të mos ngutemi për t'i proceduar, sepse ky ligj është nga viti 2004 dhe që nga atëherë nuk është ndryshuar. Po ashtu, synojmë që ta bëjmë një kod për tregti, dhe kur të bëhet, të mos ketë nevojë që të ndryshohet menjëherë. Në aspektin procedural, me Rregulloren e punës së Qeverisë, por edhe nga fushëveprimi i këtyre ligjeve, ne mendojmë se këto ligje mund të shkojnë ndaras.

Pas debatit, komisioni, me 4 (katër) vota për, dhe 3 (tri) kundër, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit që të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-040 për masat mbrojtëse në importe.*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Sala Berisha- Shala, kryetare e komisionit.*

4. Shqyrtimi i Raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016

Kryetarja, tha se në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, neni 8.1, Qeveria i përgjigjet Kuvendit për mënyrën në të cilën ajo ministri dhe njësia për politikën dhe monitorimin e NP-ve i ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë që u janë dhënë me këtë ligj. Qeveria i raporton Kuvendit, në bazë vjetore mbi performancën e këtyre autorizimeve dhe

përgjegjësve, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.1 të këtij ligji. Qeveria do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit, mbi mënyrën e menaxhimit të NP-ve qendrore, në interes të Republikës së Kosovës. Qeveria, me vendimin nr. 31/20, datë 20.12.2017, ka miratuar Raportin vjetor të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016. Raporti është proceduar në Kuvend, në dhjetor të vitit 2017, ndërsa iu është shpërndarë deputetëve, më datë 22.1.2018. Raportet e dy viteve, përmbajnë pjesën e përgjithshme, ku trajtohen çështjet e përgjithshme mbi ndërmarrjet publike, si dhe pjesën ku trajtohet secila ndërmarrje veç e veç. Në pjesën e përgjithshme, përfshihen shqyrtimet hyrëse, politikat e pronësisë mbi ndërmarrjet publike, zhvillimi i qeverisjes korporative, kuadri ligjor, objektivat e korporatës, struktura e kapitalit, opinionet e auditorëve të jashtëm, pasqyra e performancës së ndërmarrjeve, performanca e ndërmarrjeve publike sipas sektorëve (sektori i energjisë, sektori i telekomunikacionit dhe sektori i ujit) dhe punësimi nga NP-të. Ndërsa, pjesë e raporteve individuale të performancës së NP-ve, përfshihen veprimtaria e ndërmarrjes, misioni, vizioni, performanca operative dhe performanca financiare. Në fund të raportit janë paraqitur konkludimet dhe rekomandimet. Raporti, në përgjithësi, është i strukturuar mirë, është i ilustruar me tabela, diagrame dhe të dhëna statistikore. Po ashtu, paraqiti komente për raportin për vitin 2015, në faqe 8, pjesa shqyrtime hyrëse, është thënë: “Në bazë të treguesve kyçë financiarë, performanca e ndërmarrjeve nuk është ajo që pritet, ku shumica e ndërmarrjeve kanë tendencë rënëse të kthimit në pasuri, tendencë të rritjes së butë të të hyrave nga shitja, që nuk është në harmoni me zhvillimin ekonomik dhe tendencë rritëse të shpenzimeve për staf, me përjashtim të disa ndërmarrjeve”. Çka ka ndërmarrë Qeveria apo Ministria, që performanca e ndërmarrjeve të përmirësohet? Rritja e shpenzimeve për staf, a ka reflektuar në përmirësim të performancës së ndërmarrjeve? Në faqen 10, në raport, është dhënë numri i mbledhjeve të mbajtura me aksionarin, numri i mbledhjeve të mbajtura të bordeve të drejtorëve, numri i mbledhjeve të komisioneve të auditimit, dhe mbledhje të komiteteve të përkohshme të bordit, do të ishte në të mirë të informimit dhe transparencës, që të dihen diskutimet dhe vendimet kryesore që janë marrë në këto mbledhje. Kjo do të tregonte performancën e bordeve dhe organeve tjera. Po ashtu, në faqen 10 në raport thuhet: “janë organizuar tri takime të Komisionit të Ministrave për NP-të, në të cilat janë diskutuar shumë çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e NP-ve”, mirëpo në raport nuk përmenden çështjet e diskutuara, pasqyrimi i çështjeve kryesore të diskutuara dhe vendimet e marra në raport do ta pasuronte këtë raport me më shumë informata dhe do të dihej aktiviteti i atij Komisioni të Ministrave. Në faqe 13, janë pasqyruar opinionet e Auditorit, dhe nga krahasimi i vitit 2015 me vitin 2014 shohim se në vitin 2015 ka keqësim të gjendjes, pasi që dy ndërmarrje kanë shënuar përmirësim, ndërsa gjashtë prej tyre kanë degraduar. A mund ta shpjegoni pse ka ndodhur kjo dhe a është ndërmarrë ndonjë masë që të përmirësohet kjo gjendje, në mënyrë që mos të ketë degradim, por vetëm përmirësim? Në faqe 21, në tabelë, është paraqitur numri i punëtorëve të NP-ve, dhe siç shihet, në vitin 2015 janë 165 punëtorë më pak se në vitin 2014, ndërsa shpenzimet për paga janë rritur për 2.01%, a mund ta shpjegoni këtë, a do të thotë që ka pasur rritje të pagave të punëtorëve? Po ashtu, të KEK-u dhe të KOSTT-i, shihet se është zvogëluar numri i punëtorëve më shumë. A ka ndodhur kjo për shkak të privatizimit të ndonjë njësie apo kontraktimit të shërbimeve? Në raport nuk kemi parë se keni paraqitur edhe proceset gjyqësore të ndërmarrjeve dhe vendimet përfundimtare, nëse janë marrë dhe vlera e humbjeve nga këto procese. A mund të sqaroni diçka lidhur me këto procese? Paraqiti komente për raportin për vitin 2016, në faqen 9 edhe në këtë raport është dhënë numri i mbledhjeve të mbajtura me aksionarin, numri i mbledhjeve të mbajtura

të bordeve të drejtorëve, numri i mbledhje të komisioneve të auditimit dhe mbledhje të komiteteve të përkohshme të bordit. Pra, do të ishte në të mirë të informimit dhe transparencës që të dihen diskutimet dhe vendimet kryesore që janë marrë në këto mbledhje. Kjo do të tregonte performancën e bordeve dhe organeve tjera. Në faqe 15 është thënë: “Për sa i përket të hyrave totale të ndërmarrjeve publike, në vitin 2016 kanë qenë 307 mil. euro apo 7% më pak se vitin paraprak. Ndërsa, shpenzimet kanë qenë 336 mil. euro apo 1.9% më të larta se vitin 2015”. A janë dhënë subvencione për të mbuluar shpenzimet dhe sa është vlera e tyre? A mund ta sqaroni si është e mundur që krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016, ka rënie të të hyrave 7%, ndërsa rritje të shpenzimeve 1.9%. Pse nuk janë marrë masa që të zvogëlohen shpenzimet? Në faqe 19 është paraqitur zvogëlimi i numrit të punëtorëve në NP, 456 më pak 2016 sesa në 2015. Pse ka ndodhur ky zvogëlim, dhe veçanërisht në KEK, pse janë 475 më pak se në vitin 2015? Në faqe 77, te konkludimet, thuhet: “Nga të dhënat e pasqyruara në këtë Raport të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2016, dhe duke i krahasuar me periudhën paraprake, mund të raportojmë një rënie të performancës së ndërmarrjeve publike qendrore, me përjashtim të disa ndërmarrjeve, cilat janë veprimet e ndërmarra, për të parandaluar këtë performancë në rënie dhe për ta kthyer në performancë pozitive?”

Besnik Beka, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, tregoi se për arsye shëndetësore, drejtori nuk ka mundur të jetë prezent në këtë takim, dhe nga kjo situatë, për pjesën e raportimit, kam ardhur unë në cilësinë e zëvendësministrit, për të raportuar për raportin e punës për vitin 2015-2016.

Hykente Bajrami, kërkoi nga kryetarja dhe komisioni, që të shtyhet kjo pikë dhe të jetë prezent Njësia për monitorim të politikave të ndërmarrjeve publike, sepse zëvendësministri nuk mund të përgjigjet në pyetjet tuaja që i parashtruat dhe as në pyetjet që do t'i parashtrujmë, sepse zëvendësministri, me gjithë mirëkuptimin, mund të flasë vetëm për masat që këta i kanë ndërmarrë tani dhe jo në periudhat e mëhershme.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi i Raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 dhe 2016.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Kryetarja, ceku që me propozimin tuaj u fut në rend të ditës raporti i grupit të punës për Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik. Grupi i punës ka amandamentuar këtë projektligj dhe ka paraqitur këtë raport me amendamente. Për këtë projektligj, janë miratuar 14 amendamente, të cilat i paraqiti një nga një dhe u miratuan nga komisioni, pa ndonjë vërejtje.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, procedohet në komisionet e përherëshme për vlerësim, sipas kompetencës.

Raporti me amendamente i bashkëngjitet këtij procesverbali.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryetarja, sa i përket kërkesës së anëtarëve të këtij komisioni, për një zyrë të përbashkët për këtë komision, ne kemi marrë një përgjigje nga sekretari, ku thuhet se nuk kemi hapësirë për ndarjen e një zyre të tillë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
Komisioni për Buxhet dhe Financa;
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;
Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;

Datë: 27.2.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 27.2.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoj Projektligjin nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Pas titullit të Projektligjit, fshihet fjalia “DISPOZITAT E PËRGJITHSHME”.

Amendamenti 2

Neni 2, pas fjalës “aktivitetet”, shtohet fjalia “e kryera nga “Shërbimi Gjeologjik i Kosovës”.

Amendamenti 3

Neni 4, ndryshohet si vijon:

1. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës është organ i pavarur në kuadër të Ministrisë.
2. Selia e SHGJK-së është në Prishtinë.

Amendamenti 4

Neni 5, në paragrafin 1, pas fjalës “janë” shtohet teksti “si në vijim:”, si dhe fshihet fjala “bënë”, në nënparagrafet 1.1.;1.21 dhe 1.26.

Amendamenti 5

Neni 5, paragrafi 2, referenca “në nenin 5 të këtij ligji,” zëvendësohet me “sipas këtij neni.”.

Amendamenti 6

Neni 7, ndryshohet si vijon:

1. Organizimi struktura dhe funksionalizimi i brendshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, rregullohet me Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.
2. Personeli i punësuar në Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, e ka statusin e nëpunësit civil.

Amendamenti 7

Neni 11, fshihet.

Amendamenti 8

Neni 12, paragrafi 5, riformulohet si vijon:

5. Hulumtimet themelore dhe ato të detajuara gjeologjike financohen nga:
 - 5.1. Buxheti i Kosovës;
 - 5.2. Ndërmarrjet publike;
 - 5.3. Donatorët: dhe,
 - 5.4. Persona tjerë fizik e juridik të regjistruar, vendas apo të huaj.

Amendamenti 9

Neni 13, paragrafi 5, riformulohet si vijon:

5. Forma e organizimit, përdorimit dhe shfrytëzimit të materialit Arkivor të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria.

Amendamenti 10

Neni 14, ndryshohet si vijon:

1. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës ofron shërbime me pagesë për palën e tretë, bazuar në përgjegjësitë e përcaktuara sipas nenit 5 të këtij ligji.
2. Tarifat e shërbimit me pagesë për palën e tretë, përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria.
3. Institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, qoftë ato qendore apo lokale, obligohen që të marrin shërbim nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, përveç, nëse kjo e fundit nuk e ofron një shërbim të tillë.

4. Për studime dhe projekte që kryhen jashtë territorit të Republikës së Kosovës merret miratimi nga Ministri.

Amendamenti 11

Në titullin e Nenit 15, lidhëza “te” zëvendësohet me lidhëzen “dhe”.

Amendamenti 12

Neni 17, në nënparagrafet 1.2.; 1.4.; 1.5.; dhe 1.6., fjala ‘bënë’ zëvendësohet me fjalen ‘kryen’, si dhe nënparagrafet 1.7. dhe 1.8. riorganizohen dhe behën paragraf 2 dhe 3, të nenit 17.

Amendamenti 13

Neni 18, paragrafi 2, fshihet.

Amendamenti 14

Neni 19, paragrafi 1, ndryshohet si vijon:

“Ministria për zbatimin e këtij ligji, brenda një (1) viti, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr:”

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA